



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura IV**

**Sesioni vjeshor**

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Mbledhja nr. 17

Prishtinë, 22.05.2018. me fillim në 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Igor Simiq, kryetar, Xhelal Sveçla, nënkryetar i parë, Danush Ademi, nënkryetar i dytë, Kujtim Shala, Haxhi Shala, Zoran Mojsilović, Jasmina Zhivković, Sasha Milosavljeviq, Albert Kinoli dhe Veton Berisha, anëtarë.

**Munguan:** Fadil Beka, Rasim Selmanaj, Mufera Srbica Shinik, Duda Balje dhe Slobodan Petrović, anëtarë

Pjesëmarrësit tjerë: Senad Karaahmetovic- përfaqësues i OSBE-së, Zijush Ahmeti këshilltar i Sekretariatit të KKK-së dhe Celal Iliaz, drejtorja për Media dhe Marrëdhënie me Publikun.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Natasa Prica-Tishma dhe Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: Igor Simiq, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua:

**Rendi i ditës:**

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Raportimi i Ministrit për Punë dhe Mirëqenie Sociale z. Skender Reçica dhe Ministrit për Komunitete dhe Kthim z. Dalibor Jetviq lidhur me implementimin e projektit për ndërtimin e shtëpive për komunitetet joshumicë.**

**1. Miratimi i rendit të ditës.**

*Kryetari, konstatoi se komisioni miratoi rendin e ditës, pa ndryshime.*

**Kryetari, Igor Simiq** - hapi mbledhjen e sotme të Komisionit, në fillim përshëndeti pjesëmarrjen e ministrit dhe të këshilltarëve të tij.

Ai theksoi se ky plan ka për qëllim përmirësimin e jetës së komuniteteit joshumicë në fushën sociale, kështu që kërkoi sqarime lidhur me ndarjen e fondit për ndërtimin e shtëpive për banim për komunitetin joshumicë në bazë të ndarjes së mjeteve nga buxheti i vitit 2018.

## **Ministri për punë dhe çështje sociale, Skender Reçica:**

Me buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018, Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale i është ndarë buxheti për përkrahjen e komuniteteve. Duke folur për implementimin e planit për ndërtimin e shtëpive për komunitetin joshumicë, ministri tha se në bazë të Ligjit për buxhetin e vitit 2018, me kod të veçantë janë ndarë gjithsej 1.800.000 € në emër të komunitetit joshumicë, kështu që nga këto mjete do të ndërtohen shtëpitë për këtë kategori të komuniteteve, ndërsa një pjesë e mjeteve do të shpenzohen për qëllime tjera sociale. Shumat e këtyre mjeteve nuk janë të ministrisë për punë dhe mirëqenie sociale, nga ne nuk i kemi kërkuar këto mjete, por me miratimin tim janë alokuar për komunitetet joshumicë. Unë nuk e di cilat projekte janë më të nevojshme, të rëndësishme dhe për cilin komunitet, këtë ju duhet ta dini.

**Në vazhdim të ekspozesë,** ministri tha se këto mjete deri më sot nuk janë realizuar për shkak të mospajtimeve në mes të deputetëve që i takojnë komuniteteve joshumicë, dhe në qoftë se nuk arrijnë pajtueshmëri të ndërsjellë lidhur me ndarjen e këtyre mjeteve, ai do të kërkojë nga Qeveria e Kosovës që këto mjete të kthehen si suficit në buxhetin e Republikës së Kosovës. Këto mjete nuk janë të ndara vetëm për GP 6+, por janë paraparë edhe për komunitetin boshnjak, egjiptian, ashkalinj dhe turk. Në fund të ekspozesë, ministri Reçica edhe njëherë apeloi që deputetët e komuniteteve joshumicë të ulen bashkërisht, duke lënë anash mospajtimet, dhe të gjejnë një zgjidhje adekuate, në mënyrë që këto mjete të shpenzohen për atë që janë dedikuar.

Më pas, nëtarët e Komisionit paraqitën pakënaqësit e tyre dhe rekomandimet lidhur me këtë çështje:

**Veton Berisha,** me rastin e miratimit të buxhetit për vitin 2018, dhe në bazë të marrëveshjes me Qeverinë të nënshkruar nga kryeministri Ramush Haradinaj, është siguruar linja buxhetore prej 1.800.000 € për komunitetin joshumicë. Përfaqësuesit e komunitetit egjiptjan dhe goran kanë votuar kodin buxhetor, ndërsa përfaqësuesit e GP 6+ kanë bërë përpjekje që këto mjete të alokohen për komunitetin: romë, ashkali, turk dhe boshnjak.

Nëse fondi prej 1.800.000 € shfrytëzohet vetëm për grupin parlamentar 6+, atëher do të kërkojë të largohet nga Qeveria, edhe pse mendon se Qeveria nuk bie nën ndikime të tilla. Kjo çësje nuk është kërcim, por si kërkesë e imja që të bëhet interpretim kushtetues dhe ligjor të këtij projekti. Besoj se do të gjendet një mekanizëm ligjorë për zbatimin e projektit për ndërtimin e shtëpive, me qëllim të ketë përparim në këtë drejtim.

**Xhelal Svecla,** theksoi se fondi për përkrahjen e komuniteteve jo shumicë nuk është fond i partive politike dhe as fond i përfaqësuesve të komuniteteve, por fond i buxhetit të Republikës së Kosovës. Duhet të përcaktohen prioritetet për implementimin e tij, me qëllim të përkrahjes së komuniteteve pa dallim, dhe mundësia të mos lejohet kthimi i këtyre mjeteve buxhetore si suficit në Qeveri. Kërkoj që të zbatohet Ligji për Buxhetin e vitit 2018, të cilin e kemi votuar në Parlament, duke mos i marrë parasysh marrëveshjet dhe ndikimet e Qeverisë.

**Danush Adem-** Në mbledhjen plenare kur është miratuar Buxheti për vitin 2018, ne e kemi votuar një kod buxhet të veçantë për komunitetet joshumicë. Paraprakisht, në pajtim me procedurat, kemi parashtruar një amendament të nënshkruar nga PG 6+ dhe i njejtë është shqyrtuar në Komisionin për buxhet dhe financa, i cili më pas është miratuar në Kuvend. Tash kemi një grup të deputetëve që e pengojnë procesin e implementimit të këtij fondi, i për të cilin çështje ai nuk pajtohet.

Theksoi se komuniteteti ashkali, rom, egjiptian, boshnjak, turk dhe goran kanë të drejtë dhe në mënyrë të barabartë t'i shfrytëzojnë këto mjete, nga se ekziston nevoja, me qëllim të përmirësimit të kushteve sociale dhe ekonomike të këtyre komuniteteve në fjalë . Në bazë të kësaj, insistoj që ky projekt të implementohen dhe të gjenden mekanizma për realizim e tij në praktikë, me qëllim që këto mjete të mos kthehen si suficit në buxhet.

**Albert Kinolli**, theksoi se asnjë komunitet nuk është kundërshtim që të respektohen të drejtat e komunitetit tjetër. Në bazë të specifikave, ne kemi mbajtur takime në terren për çdo komunitet. Mjetet financiare janë të qytetarëve dhe tatimpaguesve të Kosovës. Ndarja e këtij fondi nuk është siguruar nga Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale, por këto mjete janë ndarë përmes kodit të veçantë buxhetor nr. 50.36. Ne do t'i shfrytëzojmë të drejtat tona lidhur me këtë fondë, sepse na takonë në bazë të Kushtetutës, si kategori kushtetuese dhe në bazë të Ligjit për Buxhetin.

Në bazë të propozim amandamentit të GP 6+ për ndarjen e mjeteve buxhetore në vlerë prej 1.800.000 euro, tha se i njejtë është votuar në Kuvend dhe jemi në pritje të zbatohet në pajtim me Ligjin për Buxhet, për vitin 2018.

**Emilija Regjepi**, theksoi se nuk është anëtare e këtij komisioni, por sot jamë e interesuar dhe kam marr pjesë në komisioni që të debatoj për këtë çështje. Deputetët e grupit parlamentar 6+, të cilët kanë qenë të zëshëm, sot nuk janë këtu, sepse është e ditur kush është përfaqësues i popullit boshnjak në Parlament dhe kur duhet të mbrohet të drejtat e komuniteteve, gjithsesi unë do ta shfrytëzojë të drejtën time dhe do të angazhohem deri në fund për zhvillimin adekuat të këtij procesi.

Ne në Parlament nuk kemi votuar për propozimin e grupit 6+, këtë e din edhe ministri Reçica, por ne kemi votuar kodin buxhetor në emër të komunitetin pakicë, gjithnjë duke u bazar në Ligjin e Buxhetit për vitin 2018. Pse ka ndodhur që GP 6+ ta tërheq amendamentin dhe të votohet diçka tjetër, është çështje e cila kërkon të pyetet ministri i financave. Falenderohet në emër të komunitetit boshnjak, që ndërlidhet me realizimin e projekteve për komunitetin Boshnjak .

**Hetem Arifi**, në bazë të diskutimeve, ai tha se duhet të implementohet kodi buxhetor i cili është miratuar në Parlament me qëllim të ndihmohen të gjitha komunitetet e jo grupet politike.

**Igor Simić**, kryetar i komisionit ka parashtruar pyetje për ministrin, e cila nuk ka të bëjë me temën e sotme. Në bazë të cilit ligj apo vendim qytetareve të komunitetit serb ne veri, me rastin e dorëzimit të kërkesës për ndonjë ndihmë sociale, kërkohet nga ata dorëzimi i kopjes së letërnjoftimit serb, të cilat institucione të Kosovës në raste të tjera nuk i njohin. Kjo praktikë është duke u zbatuar me vite. Ky është një paradoks. Në qoftë se është kjo praktike për të gjithë qytetarët, atëherë unë e tërheqë pyetjen tim, por nëse është vlen vetëm për përfaqësuesit serbë, kjo nuk është në rregull.

Mbledhja përfundoi në orën 14:10  
Njësia për përkrahje të komisionit

**Kryetari i komisionit  
Igor Simiq**